



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT
SEKTORI I PYJEVE

Nr. 996 Prot.

Fier më. 10.07.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 69, datë 10.07.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMISË PYJORE
“ VAJKAN LIBOFSHË ”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, neni 54, gërma “k”, Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, të ndryshuar, kreu III neni 11, Ligjit nr.114/2024 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin, ‘Bashki të Forta (BTF), Faza 2’ , si dhe urdhërit të Titullarit me nr. 743 prot., datë 20.01.2026 , « Për ngritjen e Grupit të punë për hartimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve 2026-2036, të Bashkisë Fier » , Kryetari i Bashkisë,

PROPOZON:

1. Miratimin e planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore “ Vajkan Libofshë “, për periudhën 2026-2036, sipas materialit të përgatitur nga Grupi i Punës, bashkëlidhur këtij projekt-vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave administrative – ligjore për miratimin e Planit të Mbarështimit në Ministrinë e Mjedisit ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit, Sektori i Pyjeve.

Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit

Sektori i Pyjeve
Ing.Rovënta Sera

Drejtoria e Administrimit dhe
Menaxhimit të Pronave
Mimoza Petushi

KRYETARI
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Zv.Kryetar
Eraldi Qirio



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT
SEKTORI I PYJEVE

Nr. 9096 / Prot.

Fier më 10.07.2026

RELACION

Të nderuar këshilltarë,

Projekt-Vendimi, « **Për miratimin e Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore “ Vajkan Libofshë , për Periudhën 2026-2036** », është përgatitur në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, neni 54, gërma “k”, Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, të ndryshuar, kreu III neni 11, VKM nr.114/2024 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin, ‘Bashki të Forta (BTF), Faza 2’ , si dhe urdhërit të Titullarit me nr. 743 prot., datë 20.01.2026 , « Për ngritjen e Grupit të punë për hartimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve 2026-2036, të Bashkisë Fier » .

Puna për hartimin e këtij plani mbarështimi i cili vjen si një detyrim ligjor për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve filloi me daljen e urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Fier me anë të së cilit u ngrit grupi i punës. Më pas procedura vazhdoi me mbledhjen e të dhënave në terren për të përcaktuar gjendjen aktuale të pyjeve në këtë ekonomi pyjore si dhe për të parashikuar ndërhyrjet e nevojshme për të arritur qëllimin kryesor për të cilin hartohet ky plan mbarështimi, i cili është ai i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Pas marrjes të sipërfaqeve provë të përcaktuara nga sistemi ALFIS puna vazhdoi me përcaktimin e ndërhyrjeve silvokulturale që do të kryhen për përmirësimin e gjendjes së fondit pyjor në bazë të nevojave që ato kanë. Më pas nga specialistët e GIS-it u hartuan hartat digitale sipas llojeve të tyre të cilat janë një dokument i rëndësishëm që i bashkëngjiten këtij plani mbarështimi. Pas përfundimit të gjithë punës u hartua ky plan mbarështimi për të cilin në zbatim të ligjit kërkojmë miratim në Këshillin Bashkiak.

Grupi i punës:

Roventa Sera
Ildo Trifoni
Majlinda Karaj

KRYETARI
Armando Subashi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

Zv.Kryetar
Eraldi Qirio

